V E N D I M
Nr. 24, datë 13.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Artan Hoxha	"
Bashkim Caka	"
Metush Saraçi	"
Natasha Sheshi	"
Agron Lamaj	"
Perikli Zaharia	"
Evgjeni Sinoimeri	"
Valentina Kondili	"
Vladimir Bineri	"
Ylvi Myrtja	"
Zamir Poda	"
Nikoleta Kita	"
Vladimir Metani	"
Irma Bala	"
Spiro Spiro	"

në seancën gjyqësore të datës 13.3.2002, morën në shqyrtim çështjen civile nr. 19, që i përket:

PADITËS I KUNDËRPADITUR: RAMADAN LLAPAJ

E PADITUR KUNDËRPADITËSE: VJOLLCA LLAPAJ

TË PADITUR: ISMIHAN PIRGU
KEMAL PASHALLARI
FLUTURA LLAPAJ

OBJEKTI I PADISË: Deklarimi i pavlefshëm i veprimit juridik, kontrata dhurimi.
BAZA LIGJORE: Neni 92 e vijues të Kodit Civil.

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: Deklarimin e pavlefshëm të kontratave të dhurimit në favor të të padituresë Flutura Llapaj.

BAZA LIGJORE: Neni 92 e vijues të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1505, datë 27.4.1998,
ka rrëzuar padinë dhe pranuar kundërpadinë, duke deklaruar të pavlefshëm kontratat e dhurimit me nr.11614 Rep. e Nr.5208 Kol. dhe nr.11615 Rep e nr.5209 Kol. datë 12.6.1996, si kontrata të fallsifikuara duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme.
Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.829, datë 14.9.2000,

ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bërë rekurs paditësi i kundërpaditur, Ramadan Llapaj duke parashtruar këto shkaqe:

1. Bashkëshortët janë martuar në vitin 1966 dhe janë ndarë në vitin 3.5.1997.

Në vitin 1993 e paditura kundërpaditëse ka fituar disa prona nëpërmjet Komisionit të Kthimit të Pronave.

2. Kontratat e dhurimit janë të vitit 1994 e 1996, vlefshmëria e tyre përcaktohet nga dispozitat e Kodit Civil.

3. Neni 1167 i këtij Kodi (viti 1994) përcakton se bashkëpronësia zgjidhet sipas nenit 86 të Kodit Civil të 1981.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1292, datë 20.11-2001, ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me atë nëse ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-Pronarëve dhe ai për të përndjekurit politikë, janë mënyra fitimi pronësie dhe nëse duhet konsideruar pasuri bashkëshortore ajo e ardhur me trashëgim dhe e kthyer më vonë sipas këtyre ligjeve.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Artan Hoxha e Nikoleta Kita, mbrojtësen e paditësit të kundërpaditur, avokat Hanëme Bakia, e cila kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pranimin e padisë, mbrojtësin e të paduruës kundërpaditëse, avokat Viktor Konomi, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.829, datë 14.9.2000, është i bazuar në ligj e për këtë shkak duhet lënë në fuqi.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se palët ndërgjyqëse Vjollca Llapaj dhe Ramadan Llapaj kanë qenë bashkëshortë me njëri-tjetrin që nga viti 1966, deri sa është zgjidhur martesa mes tyre nga Gjykata e Tiranës në vitin 1997. Paditësi i kundërpaditur Ramadan Llapaj ka ngritur padi ndaj të paduruës kundërpaditëse Vjollca Llapaj dhe të paduruve Ismihan Pirgu, Kemal Pashallari dhe Flutura Llapaj, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të disa veprimeve juridike, kontrata dhurimi, me të cilat e paditura kundërpaditëse ka kaluar në pronësi të të paduruve të tjerë disa pasuri të paluajtshme. Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se sendet objekt i kontratave të dhurimit janë fituar gjatë martesës dhe, për rrjedhojë, i nënshtrohen regjimit martesor të bashkëpronësisë të parashikuar nga Kodi Civil i vitit 1981, regjim i cili për disponimin e sendeve të paluajtshme kërkon pëlqimin e të dy bashkëshortëve (neni 87/2). Kontratat e dhurimit janë lidhur në periudhat 1994 e 1996, kohë gjatë të cilës palët kanë qenë të martuar. Sipas paditësit, nuk është marrë pëlqimi i tij për tjetërsimin e kësaj pasurie të paluajtshme, e cila ka kaluar në favor të pranuesve të dhurimit të thirrur si të paditur në këtë gjykim.

Nga e paditura kundërpaditëse Vjollca Llapaj është pretenduar se pasuria që ajo ka fituar me trashëgimi ligjore, të cilën ajo e ka tjetërsuar me këto kontrata dhurimi në favor të të paduruve, njëkohësisht fëmijët e saj, nuk është pasuri bashkëshortore, por pronë vetëm e saj e, për këtë shkak, nuk ka qenë i nevojshëm pëlqimi i bashkëshortit tjetër për tjetërsimin e kësaj pasurie.

Nga gjykimi ka rezultuar se e paditura kundërpaditëse, me vendime të Bashkisë Tiranë dhe të Komisionit të Kthimit të Pronave, në vitet 1993 e 1994 ka përfituar 1 /8 pjesë të trashëgimisë së trashëgimlënësve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi dhe Fehmi Kazazi, të cilët kanë

qenë të shpronësuar dhe të konfiskuar nga shteti sipas ligjit të kohës në vitin 1950. Me këto vendime, trashëgimtarëve të tyre iu është njohur e kthyer pasuria, ku përfshihen ndër të tjera edhe e drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, të cilat janë disponuar me kontratat e dhurimit që kërkohet të deklarohen të pavlefshme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1505, datë 27.4.1998, ka rrëzuar kërkesë - padinë, ndërkohë që ka pranuar kundërpadinë, duke deklaruar të pavlefshme kontratat e dhurimit me nr.11614 Rep. e nr.5208 Kol. datë 12.6.1996 dhe Nr. 11615 Rep. e nr.5209 Kol. datë 12.6.1996, për shkak të falsitetit të tyre. Në rigjykim, mbas prishjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të mëparshëm, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Civil, me vendimin e datës 20.11.2001, ka vendosur të kalojë aktet për unifikim të praktikës gjyqësore në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të shprehur ky i fundit lidhur me faktin se do të konsiderohet ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish - pronarëve dhe ai për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, si mënyrë e re e fitimit të pronësisë apo si korrigjim i një situate të mëparshme të konsideruar në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në varësi të zgjidhjes së mësipërme, të përcaktojë nëse janë ose jo pasuri e përbashkët e bashkëshortëve sendet objekt i kontratave të dhurimit të sipërshënuara.

Marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe pretendimet e ngritura më sipër për mënyrën e fitimit të pronësisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se është e nevojshme të unifikohet praktika gjyqësore, si më poshtë:

Ligji nr. 7514, datë 30.9.19 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish - të përndjekurve politikë" dhe ligji nr.7698, dt.15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" nuk janë mënyra të reja të fitimit të pronësisë, por korrigjim i padrejtësisë së bërë dhe, për këtë qëllim , shfuqizojnë ipso lege të gjitha aktet e mëparshme ligjore, me të cilat u ishte marrë prona pronarëve padrejtësisht . Ato nuk krijojnë një situatë të re, (nuk kanë efekt konstituitiv), por ristabilizojnë ligjshmërinë dhe drejtësinë.

Shfuqizimi i akteve të sipërpërmendura, ka si efekt kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke rregulluar në masën më të mundshme, situatën e paligjshmërisë lidhur me të drejtën reale më të rëndësishme , atë të pronësisë (jo të drejta të tjera reale e aq më pak të drejtat e detyrimeve). Në këtë këndvështrim, kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i plotë, por i pjesshëm (restitutio in parte).

Nëpërmjet këtyre akteve normative u njihet e drejta e pronësisë ish-pronarëve , ose trashëgimtarëve të tyre , dhe u përcaktuan modalitetet për gëzimin efektiv të saj . Për shkak të kohës së gjatë të paligjshmërisë dhe pamundësisë objektive të kthimit fizik të të gjitha pronave të marra, ligji parashikon, për rastet kur kjo e para nuk është e mundur, alternativën e kompensimit.

Për të arritur në këto përfundime, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazohen në interpretimin e vetë akteve normative të dala për këtë qëllim dhe shikimin e tyre në raport me situata juridike analoge, duke marrë për bazë gjithashtu, edhe mënyrat e fitimit të pronësisë:

I. Si rezultat i interpretimit historik përcaktohet kuptimi i një dispozite ligjore, duke u nisur nga qëllimi që ka ndjekur ligjvënësi në një kontekst të caktuar historik, në miratimin e një akti normativ. "Ekspozimi i motiveve" për miratimin e një ligji del në veçanti nga preambula e ligjit, në rast se akti normativ e ka një të tillë, si dhe nga tërësia e normave që e formojnë atë.

Në rastin në shqyrtim, në dallim nga teknika legislative e përdorur në përgjithësi në Shqipëri në hartimin e ligjeve ligji për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish - të dënuarve dhe të përndjekurve politike, ka një preambul ku shpjegohet qëllimi dhe "ekspozohen motivet" e ligjvënësit. Në preambulën e këtij ligji është pranuar se: "Gjatë 45 vjetëve, shumë qytetarë shqiptarë janë akuzuar, gjykuar, dënuar dhe burgosur, internuar, apo përndjekur, për shkelje të natyrës politike, duke dhunuar të drejtat e tyre civile, sociale, morale dhe ekonomike." Marrë për bazë këtë, ligji shprehet se ka për qëllim të krijojë një sistem juridik të drejtë e të ndershëm, të

bazuar në të drejtat njerëzore dhe se përcakton masa për të kompensuar, rehabilituar dhe riintegruar në shoqëri të gjithë ata të cilët kanë vuajtur këtë dhunim të të drejtave të tyre. Ky ligj, në nenin 1, konsideron të pafajshëm dhe i quan të padënuar për efekte morale, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë ata që janë dënuar për shkaqe politike. Ndër të tjera, ne nenin 5, ligji ka parashikuar të drejtën e kthimit ose kompensimin e pasurive të konfiskuara.

Nga ana tjetër, edhe në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish - pronarëve", neni 1, nga i cili rezulton thelbi i ligjit, përcaktohet se: "Ky ligj u njeh ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore (duke përfshirë edhe ligjin nr.37, datë 31.1.1945 "Për tatimin a jashtëzakonshëm" nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompesimin e tyre ".

Sikurse rezulton, këto akte normative, pasuar edhe nga ndryshime dhe përmirësime të mëvonëshme, kanë të njëjtin qëllim idem animus.- Ato, ipso lege kanë shfuqizuar efektet e akteve ligjore e nënligjore, si dhe vendimet e gjykatave veprimet e tjera, nëpërmjet të cilave është marrë padrejtësisht prona ish-pronarëve të ligjshëm nga shteti i asaj kohe. Ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative, ka njohur padrejtësinë, shkeljen e të drejtave të pronësisë ish-pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre, duke iu kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi duke i kompensuar ato.

Nga sa më sipër, rezulton se këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kish ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i saj ishin sende të paluajtshme.

2. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i konsiderojnë këto akte ligjore që u drejtohen ish-pronarëve apo trashëgimtarët e tyre, jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe e bëjnë efektive atë duke e bazuar edhe në argumente analogjie.

Si në titullin e ligjit (rubrica legis fit lex), ashtu edhe në përmbajtjen e tyre përdoret nocioni kthim i pronës. Me fjalë të tjera, kthimi i pronave ish - pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre është thelbi dhe qëllimi i këtyre ligjeve (anima legis dhe ratio legis).

Nocionin kthim i pronës ose, më saktë, kthim i sendit objekt i së drejtës së pronësisë, Kodi Civil e përmend në rastin e padisë për kërkimin e sendit (actio rivendicatio), neni 296 e vijues i tij. Në rastin, kur pranohet padia e rivendikimit, poseduesi jopronar duhet t'i kthejë sendin paditësit në favor të të cilit është njohur e drejta e pronësisë. Praktika gjyqësore ashtu edhe literatura juridike, në këto raste nuk kanë vënë kurrë në dyshim ekzistencën e së drejtës së pronësisë të pronarit joposedues, mbi sendin objekt të padisë së rivendikimit. Pronari joposedues nuk ka humbur për asnjë moment titullin e së drejtës së pronësisë, por vetëm posedimin e sendit. Pikërisht kjo është arsyeja pse ligji e kthen atë në situatën e mëparshme, duke i njohur të drejtën e kthimit edhe të frutave të sendit (restitutio in integrum), dhe kur kjo nuk është e mundur, pranon vetëm kthimin e sendit (restitutio in parte).

Në kohën e daljes së kuadrit ligjor për kthimin e pronave ish - pronarëve, ligjvënësi mund të parashikonte edhe rrugën gjyqësore të kërkimit dhe kthimit të pronave të shtetëzuara apo konfiskuara padrejtësisht, por çmoi më të përshtatëshme rrugën administrative dhe të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve administrative të ngarkuara për këtë qëllim. Në rastin se do të pranohej zgjidhja e parë edhe analogjia do të ishte më e dukshme.

Për sa më sipër Kolegjet, sipas parimit të vjetër të së drejtës "ubi eadem est ratio, ibi eadem est solutio" vleresojnë se kur motivet janë të njëjta edhe zgjidhja duhet të jetë tillë.

3. Në arritjet e përfundimeve të saj, Gjykata ka, gjithashtu, parasysh mënyrat e fitimit të pronësisë të cilat ndahen në dy kategori të mëdha:

Mënyra me titull origjinale e fitimit të pronësisë, e njohur ndryshe si mënyra primare, kur

pronësia mbi sendin fitohet për herë të parë, apo pavarësisht nga e drejta e pronarit të mëparshëm mbi të. Kjo mënyrë përfshin rastet e fitimit të pronësisë mbi sendin e gjetur, me bashkim e përzjerje, me parashkrim fitues, etj. si dhe me shtetëzim, shpronësim a konfiskim.

Mënyra tjetër e fitimit të pronësisë është ajo me titull të prejardhur, ku pronari i ri këtë titull e fiton nga pronari i mëparshëm si rezultat i një kontrate, apo si pasojë e vdekjes së tij, nëpërmjet çeljes së trashëgimisë. Në këtë rast, sendi transferohet nga pronari i mëparshëm në një pronar tjetër i cili konsiderohet si fitues i pronësisë.

Të paditurës kundërpaditëse, si rezultat i aplikimit të këtij legjislacioni, i është njohur e drejta e pronësisë mbi pronën e lënë nga trashëgimlënësit e saj, ashtu sikurse kanë përcaktuar aktet e organeve kompetente, respektivisht Bashkia Tiranë dhe Komisioni i Kthimit të Pronave të kësaj Bashkie. Me fjalë të tjera, ajo ka fituar pronësinë me titull të prejardhur, por që kjo pronësi për shkak të anomalisë ligjore sikurse u trajtua më sipër, u bë e mundur të ushtrohej efektivisht mbi pasurinë e trashëguar, vetëm si rezultat i ligjeve të cituara dhe të vendimeve të marra në zbatim të tyre nga organet kompetente. Pra, e paditura kundërpaditëse është fituese e pasurisë trashëgimore, ku përfshihen ndër të tjera edhe ato pasuri të palujatshme, për të cilat ka disponuar me kontratat dhurimi, që nga momenti i çeljes së trashëgimisë (ex tunc).

Marrë shkas nga kjo, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë e të njëllojtë të çështjeve të kësaj natyre në përgjithësi, krijimin e një mendimi unik lidhur me ligjin që aplikohet për marrëdhënien juridike të trashëgimisë, në rastin e konkurrimit në kohë të disa ligjeve që regullojnë këtë marrëdhënie.

Për këtë, Kolegjet unifikojnë praktikën gjyqësore si më poshtë:

Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashgimlënësit, fizikisht të konstatuar ose të përcaktuar me vendimin gjyqësor të shpalljes së vdekjes. Përcaktimi i këtij momenti është i një rëndësie të veçantë praktike pasi në funksion të tij përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi, të drejtat e tyre dhe momenti i kalimit të së drejtës së trashëgimisë. Është ky moment, ai që përcakton edhe ligjin e aplikueshëm lidhur me efektet që pasojnë çeljen e trashëgimisë. Duke u bazuar në parimin ligji civil, si rregull, nuk ka fuqi prapavepruese (retroactive) dhe, në rastin konkret, as fuqi pasvepruese (ultraktive), arrijmë në përfundimin se ligji që i zbatohet marrëdhënies së trashëgimisë është ligji në fuqi në kohën e çeljes së saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të arritur në këtë konkluzion i referohen legjislacionit civil, dekretit "Mbi trashëgiminë" të vitit 1954, neni 2 të tij, Kodit Civil të vitit 1981, nenit 95 dhe nenit 318 të Kodit Civil në fuqi. Sipas këtyre dispozitave, por edhe ashtu sikurse praktika gjyqësore ka pranuar, momenti i çeljes së trashëgimisë është ai i vdekjes së trashëgimlënësit dhe ligji që aplikohet në këtë rast, është ligji që ka qenë në fuqi në atë kohë.

Duke iu referuar praktikës gjyqësore, rezulton ndër të tjera se Gjykata e Lartë, me vendim të Pleniumit të saj nr.2, datë 28.2 dhe 2.3.1964, është shprehur se: "Për trashëgimitë e çelura përpara hyrjes në fuqi të dekretit "Mbi trashëgiminë zbatohet ligji që ka qenë ne fuqi në kohën e çeljes së trashëgimisë ". Ky qëndrim i Plenumit të Gjykatës së Lartë është mbajtur edhe në praktikën e mëvonshme gjyqësore, gjë që ka buruar drejtpërdrejt nga legjislacioni civil, i cili, megjithëse i ndryshuar në vite, ka mbetur konseguent lidhur me momentin e çeljes së trashëgimisë dhe ligjin e aplikueshëm.

Në çeshtjen në gjykim, rezulton se e paditura kundërpaditëse dhe njëkohësisht dhuruese, Vjollca Llapaj, është një nga trashëgimtarët e trashëgimlënësve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi e Fehmi Kazazi, të cilët kanë vdekur respektivisht në vitet 1972, 1979 dhe 1981. Pasuria që ata kanë lënë në trashëgim, ka qenë pasuri e konfiskuar në favor të shtetit për shkaqe politike dhe që u është kthyer trashëgimtarëve të tyre, përfshi edhe të paditurën kundërpaditëse, me vendim të organeve kompetente në vitet 1993 e 1994. Duke qenë se e paditura kundërpaditëse ka hyrë në posedimin e një pjese të pasurisë trashëgimore në këtë periudhë, nga paditësi i kundërpaditur, duke marrë për bazë faktin se neni 86 i Kodit Civil të vitit 1981 është akoma në fuqi, e konsideron këtë pasuri si pasuri të ardhur (fituar) gjatë martesës e, për pasojë, bashkëshortore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pranojnë të drejtë arsyetimin e bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë lidhur me ligjin e aplikueshëm për rastin në shqyrtim dhe pasojat që sjell ai për zgjidhjen e çështjes dhe nuk e gjejnë të bazuar pretendimin e paditësit kundërpaditës. Ashtu sikurse është arsyetuar më sipër, trashëgimlënësit e të padituresë kundërpaditëse kanë vdekur përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, në kohën kur në fuqi ishte dekreti nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë", Kodi i Familjes i vitit 1965 dhe dekreti nr.2083, datë 6.7.1955 "Për pronësinë". Për pasojë, ashtu sikurse edhe u unifikua, janë këto ligjet e aplikueshme për përcaktimin e pasurisë së

përbashkët të bashkëshorteve dhe regjimin juridik të saj. Sipas nenit 96 të dekretit "Mbi pronësinë", përcaktohet se: "Pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët u përkasin në tërësi të dy bashkëshortëve. Në pasuritë e përbashkëta të bashkëshortëve nuk përfshihen sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose me trashëgim depozitat që ka secili në arkat e kursimit, sendet e përdorimit thjeshtë personal, si dhe sendet dhe veglat e ushtrimit të veprimtarisë ose mjeshtërisë së tyre ".

Duke marrë për bazë këtë përcaktim ligjor, rezulton se pasuria trashëgimore e fituar nga e paditura kundërpaditëse nuk duhet të konsiderohet si pasuri bashkëshortore dhe, për pasojë, si pronare e vetme ajo ka patur të drejtë ta disponojë atë me vullnet të lirë, edhe duke e tjetërsuar në pronarë të tjerë, në respektim të dispozitave ligjore në fuqi. Kontratat e dhurimit, me të cilat pasurinë e saj trashëgimore të përcaktuar në to, ajo ia ka dhuruar fëmijëve të saj pa pëlqimin e bashkëshortit, paditësit të kundërpaditur, janë veprime juridike të ligjshme dhe të vlefshme e për pasojë, nuk mund të shfuqizohen me vendim gjyqësor.

Fakti që e paditura kundërpaditëse u bë efektivisht sunduese e pasurisë trashëgimore vetëm në vitin 1993 dhe 1994, nuk ndryshon regjimin juridik të saj. Nuk duhet konfonduar momenti i fitimit të së drejtës, me momentin e gëzimit efektiv të saj. Këtë periudhë të kaluar, nga momenti i fitimit të të drejtës së pronësisë, deri në posedimin e pasurisë trashëgimore, literaturë juridike e konsideron si gjendje të trashëgimisë së pezulluar. Pra, fituesi i pasurisë trashëgimore, e paditura kundërpaditëse, për shkaqe të pavarura prej saj, nuk ka pasur mundësi të vihet në posedim të pasurisë trashëgimore, gjë të cilën ajo e bëri të mundur, vetëm pas korrigjimit të kësaj gjendjeje, me ligjet e referuara më sipër.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke marre për bazë sa mësipër, arrijnë në përfundimin se e paditura kundërpaditëse me kontratat e dhurimit nr. 1 1551 Rep. datë 29.6.1994, nr. 1241 1 Rep. datë 17.12.1996, nr. 12412 Rep. datë 17.12.1996, nr.12413 Rep. datë 17.12.1996, nr.12414 Rep. datë 17.12.1996, nr. 12415 Rep. datë 17.12.1996 dhe nr. 125 01 Rep. datë 19.12.1996, ka tjetërsuar pasurinë e saj, në favor të të padituruve Ismihan Pirgu, Kemal Pashallari dhe Flutura Llapaj, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, për pasojë, këto akte të përpiluara përpara noterit janë të ligjshme dhe vendimet e gjykatave të ankimuara janë të bazuara dhe duhen lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë",

V E N D O S Ë N:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.829, datë 14.9.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore, sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, që njehson praktikën gjyqësore.

ARSYETIM PARALEL

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se, me vendim të Bashkisë dhe Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, është njohur pronësia e ish-pronarëve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi dhe Fehmi Kazazi, të vdekur në vitet 1972, 1979 dhe 1981. Pronësia e njohur u është kthyer trashëgimtarëve të tyre, midis të cilëve edhe të padituërs kundërpaditëse Vjollca Llapaj, që ka përfituar 1/8 e trashëgimisë.

E paditura kundërpaditëse ka qenë e martuar që nga viti 1966 me paditësin e kundërpaditur Ramadan Llapaj dhe martesa ndërmjet tyre është zgjidhur në vitin 1997. Gjatë kohës së martesës, në vitet 1994 dhe 1996, e paditura kundërpaditëse Vjollca Llapaj, me disa kontrata dhurimi, i ka kaluar në pronësi të padiurve të tjerë pjesë të pasurisë së njohur dhe kthyer si trashëgimtare e ish-pronarëve.

Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se sendet objekt i kontratave të dhurimit janë fituar gjatë martesës dhe, në bazë të nenit 86 të Kodit Civil të vitit 1981, që është akoma në fuqi ato konsiderohen si pasuri bashkëshortore dhe nuk mund të dhuroheshin nga e paditura kundërpaditëse në vitet 1994 dhe 1996 pa dijeninë e tij si bashkëshort i saj.

Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës, me të cilin ishte vendosur rrëzimi i kërkesë padisë dhe pranimi i kundërpadisë. Çështja është kaluar për unifikim të praktikës në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për t'u shprehur nëse do të konsiderohet ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe ai për pafajësinë, amnistinë dhe reabilitimin e ish-dënuarëve dhe të përndjekurve politike, si mënyrë fitimi pronësie apo si korigjim i një situate të mëparshme dhe, në vartësi të zgjidhjes së mësipërme, të përcaktojë në se janë ose jo pasuri bashkëshortore sendet objekt i kontratave të dhurimit të përmendura.

Përgjithësisht jam dakort me unifikimin e qëndrimit se ligjet e cituara nuk janë mënyra të fitimit të pronësisë, por korigjim i padrejtësisë së bërë dhe që kanë si efek rregullimin në masën më të mundshme të paligjshmërisë lidhur me pronësinë. Nëpërmjet këtyre ligjeve shteti merr përsipër të njohë ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe t'i ripronësojë ata me ato prona që juridikisht dhe faktikisht është e mundur të kthehen. Këto ligje u njohin ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe nëpërmjet kthimit që u bëhet nga organet e administratës ish-pronarët rivendosen në target e tyre si pronar, tagre këto që i kishin humbur nëpërmjet shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit, si dhe në çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga ana e shtetit.

Mendimi im i kundërt qëndron në lidhjen që bëhet për aplikimin e dispozitave që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë bashkëshortore.

Është e drejtë të arrihet në përfundimin se e paditura kundërpaditëse është fituese e pasurisë trashëgimore që nga momenti i çeljes së trashëgimisë. Por nuk është i saktë rrëzimi i pretendimeve të paditësit të kundërpaditur vetëm nisur nga fakti se trashëgimlënësit e të padituërs kundërpaditëse kanë vdekur para hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, kur ishin në fuqi dekreti "Mbi trashëgiminë" i vitit 1954, dekreti "Mbi pronësinë" i vitit 1955 dhe Kodi i Familjes i vitit 1955, të cilët nuk i përfshinin në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve sendet që secili kishte fituar gjatë martesës me trashëgim, për këto arsye:

1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë mbajtur parasysh se parimi

"Ligji civil si rregull nuk ka fuqi prapavepruese" bën përjashtim për bashkëshpronësinë ndërmjet bashkëshortëve , për shkak të përcaktimit të bërë nga vetë ligji civil shqiptar.

Ne nenin 1167 të Kodit Civil që është në fuqi, në mënyrë të shprehur thuhet se " ligji nr.6340, datë 26.6.1981 " Për Kodin Civil", përveç dispozitave për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, shfuqizohet. "Kjo do të thotë se dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981, lidhur me bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve janë ende në fuqi. Ligjëvënësi në Kodin Civil ka përcaktuar, gjithashtu, në një dispozitë të veçantë (neni 231) se bashkëpronësia ndërmjet bashkëshorteve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes. Aktualisht është në fuqi Kodi i

Familjes, miratuar me ligjin nr.6599, datë 29.6.1992, i cili nuk rregullon bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, e cila, siç u tha rregullohet nga Kodi Civil i mëparshëm.

Sipas nenit 86 të Kodit Civil të mëparshëm (1981), janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës. Efektet e këtij ligji do të shtrihen nga momenti i hyrjes së këtij ligji në fuqi dhe do të vazhdojnë përderisa ligji të mos jetë shfuqizuar.

Më parë se të hynte në fuqi Kodi Civil i vitit 1981, bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve është rregulluar nga Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.4020, datë 23.6.1965, i cili në nenin 45, paragrafi i parë përcaktonte se " pasuria që ka një bashkëshort në kohën e lidhjes së martesës mbetet pasuri e tij", ndërsa paragrafi i dytë e trajton natyrën juridike të pasurisë së vënë gjatë martesës, duke parashikuar se "Pasuria e fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës, bëhet pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme." Në bazë të nenit 46 të Kodit të Familjes, sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim apo me trashëgimi nuk përfshihet në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, sepse ato nuk jane rezultat i punës së tyre. Këtë mënyrë trajtimi ligjor ka patur pasuria e bashkëshortëve edhe nga neni 96 i ligjit " Mbi pronësinë", sipas të cilit "pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës u përkasin në tërësi të dy bashkëshortëve."

Kodi i Familjes së vitit 1965 dhe legjislacioni para tij, dhurimet dhe pasurinë trashëgimore nuk e konsideronin pasuri bashkëshortore, ndryshe nga rregullimi i bërë edhe aktualisht nga Kodi Civil, që konsideron si pasuri bashkëshortore çdo gjë të fituar nga bashkëshortët gjatë martesës, pra edhe pasurinë që vjen nëpërmjet trashëgimisë apo pasurinë që i vjen njërit prej bashkëshortëve nëpërmjet dhurimit.

Praktika gjyqësore dhe mendimet juridike kanë trajtuar edhe çështjen e efektit prapaveprues të ligjeve të dala pas çlirimit të vendit, për marëdhënie pasurore të lindura midis bashkëshorteve që kanë lidhur martesë në kohën e legjislacionit të vjetër. Ky problem i diskutueshëm në atë kohë, ka gjetur trajtimin në nenin 170 të Kodit të Familjes (1966), që shprehet se " Dispozitat e këtij Kodi për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve, si dhe për marrëdhëniet pasurore të tyre, zbatohen edhe për martesat e lidhura para hyrjes së tij në fuqi.

Duke qenë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm se ligji i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, edhe Kodi Civil i vitit 1981, ashtu si edhe Kodi i Familjes së vitit 1966, përsa i përket pasurisë së bashkëshortëve ka fuqi prapavepruese, për asrye se vetë ligjvënësi e ka përcaktuar një gjë të tillë. Kështu, në paragrafin e dytë të nenit 352 të Kodit Civil të vitit 1981 është përcaktuar se " Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për marrëdhëniet e pronësisë midis bashkëshortëve të lindura para hyrjes së tij në fuqi, në qoftë se nuk është pjesëtuar me marrëveshje të bashkëshortëve, me vendim gjyqësor ose me akt noterial."

2. Shumica, nisur nga rregulli juridik me karakter të përgjithshëm se ligji i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, mban indirekt qëndrimin se pasuria bashkëshortore do të përcaktohet nga ligji që ka qenë në fuqi në momentin kur njëri nga bashkëshortët fiton të drejtën e pronësisë të ardhur nga trashëgimia, në mometin e çeljes së saj. Në këtë mënyrë, për pronën që njihet dhe kthehet në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave do të kemi dy qëndrime; kur është fjala për: prona njohura e të kthyera si pasuri trashëgimore para vitit 1981, atëherë pasuria që vjen nga trashëgimia nuk do të konsiderohet si pasuri bashkëshortore, ndërsa kur vjen si pasuri trashëgimore pas kësaj periudhe, pasuria që vjen nga trashëgimia do të konsiderohet si pasuri e të dy bashkëshortëve pavarësisht se cilit prej tyre i vjen prona nëpërmjet trashëgimisë.

Nga ana tjetër qëndrimi i mbajtur nga shumica vendos në pozita pabarazie personat që fitojnë pronësinë si trashëgimtar në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish - pronarëve me personat e tjerë trashëgimtarë të pasurisë së paluajtshme që nuk trajtohen nga këto ligje. Ndonëse ndodhen në pozitë të njëjtë juridike, me zgjidhjen e dhënë nga Kolegjet e Bashkuara ata do të trajtohen në mënyrë të diferencuar.

Kështu, dy bashkëshort kanë lidhur martesë në vitin 1966 dhe e kanë zgjidhur atë në vitin 1997 (si palët në gjykim). Për shkak të vdekjes së trashëgimlënësve në vitet 1972,1979 dhe 1981

(si në rastin në gjykim) njëri nga bashkëshortët bëhet trashëgimtar i pasurisë së tyre. Në bazë të ligjit që ishte në këtë kohë në fuqi (para miratimit të Kodit Civil të vitit 1981) kjo pasuri e ardhur njërit bashkëshort me trashëgimi nuk konsiderohej si pasuri bashkëshortore. Por, siç u tha, martesa ka vazhduar edhe më pas, deri në vitin 1997, kur Kodi Civil i vitit 1981 edhe pasurinë e ardhur trashëgimi e konsideronte si pasuri bashkëshortore. Për shkak të fuqisë prapavepruese të dispozitave për pasurinë bashkëshortore që analizuam, do të trajtohet si e tillë edhe pasuria që kanë fituar bashkëshortët para se të hynte në fuqi Kodi Civil i vitit 1981. Ky ka qenë rregullimi ligjor i bashkëpronësisë ndërmjet bashkëshortëve dhe praktika gjyqësore e ndjekur mbas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, i aplikueshëm edhe aktualisht.

3. Ky qëndrim i mbajtur nga Kodi Civil i vitit 1981, lidhur me pasurinë bashkëshortore dhe që vazhdon të ngelet një dispozitë detyruese për zbatim për shkak se nuk është shfuqizuar me nenin 1162 të Kodit Civil të vitit 1994, është reflektim i drejtpërdrejtë i Kushtetutes së vitit 1976 dhe qëndrimit të njohur të asaj Kushtetute lidhur me pronën private. E trajtuar si bashkëpronësi në tërësi, bashkëpronësia bashkëshortore merr formën e bashkëpronësisë së detyruar dhe kështu, jashtë vullnetit të bashkshortit që ka fituar pronësinë për shembull me trashëgimi apo dhurim, nëpërmjet rregullimit të parashikuar nga ligji në fuqi, kthehet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, bashkëpronësi kjo që nuk lind nga vullneti i palëve, por nga vullneti i ligjit.

Krijimi në këtë mënyrë i bashkëpronësisë së detyruar të pasurisë bashkëshortore, edhe për pronësinë e fituar nga secili nëpërmjet rrugëve klasike të fitimit të pronësisë: bie ndesh me dispozitat kryesore kushtetuese, që njeh dhe mbron të drejtat themelore të pronësisë private dhe më pas edhe me Kushtetutën që përcakton në nenin 41, pika 2 se “Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Kodin Civil.“

Arsyetimi i mësipërm përputhet me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.4/1994, me të cilin u shfuqizuan si antikushtetues nenet 12/1 dhe 17 të ligjit “ Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve”, për shkak edhe të krijimit padrejtësisht edhe të bashkëpronësisë së detyrueshme, duke u shprehur se “…Bashkëpronësia në pjesë apo në tërësi në çdo rast krijohet mbi bazën e vullnetit të lirë e të marrëveshjes midis pronarëve të veçantë e jo në mënyrë të detyrueshme me imponim shtetëror dhe forcën e ligjit. Ajo mund të krijohet edhe nëpërmjet faktit juridik që sjell suksesim universal, siç është për shembull trashëgimia, por në çdo rast ajo nuk mund të qëndrojë pa vullnetin e bashkëpronarëve.”

Bazuar në argumentimet e mësipërme, jo vetëm në zbatin të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave apo të ligjit mbi amnistinë dhe rehabilitimin e të përndjekurve politikë, por në tërësi për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, duhet të mbahet qëndrimi i legjislacionit shqiptar në kohën që njihte qoftë edhe me kufizime pronën private, si dhe qëndrimi i legjislacioneve aktuale të vendeve të tjera perëndimore që, bashkëpronësia bashkëshortore përfshin të mirat e fituara nga bashkëshortët qoftë edhe veç e veç gjatë martesës, duke përjashtuar të mirat që u përkasin atyre para martesës, ato të fituara nëpërmjet trashëgimisë apo dhurimit, të mirat materiale për përdorim të ngushtë personal si dhe ato që shërbjenë për ushtrimin e profesionit.

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet që bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, të pezullonin gjykimin dhe materialet t'i dërgoheshin Gjykatës Kushtetuese, e cila të shprehej për kushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit Civil të vitit 1981 për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve ose bazuar në parimin “ ius cures lex” e drejta kuron ligjin- të unifikonte qëndrimin për pasurinë bashkëshortore, në përputhje me definicionin e dhënë më sipër. Mendimin tim e argumentova si arsyetim paralel, për arsye se qëndrimi i dytë më duket më i drejtë dhe se pavarësisht nga mendimi i ndryshëm dhe shkaqet e tij, zgjidhja e çështjes konkrete koicidon me atë të shumicës.

Gjyqtar: B. Caka